



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 83

Tiranë – E premte, 8 maj 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 377, datë 8.5.2020	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë..... 4681
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 286, datë 30.4.2020	Për një shtesë dhe ndryshim në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 4685
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 287, datë 30.4.2020	Për disa ndryshime në urdhrin nr 263, datë 17.4.2020 “Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen e mjeteve private”, të ndryshuar..... 4685
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 288, datë 30.4.2020	Për disa shtesa në urdhërin nr.279, datë 25.4.2020 “Për lehtësimin e posaçëm të lëvizjes në “Zonat e Gjelbërta”..... 4686

**VENDIM****Nr. 377, datë 8.5.2020****PËR KALIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË TIRANË, TË PASURISË
NR.1/241, ME EMËRTIMIN “TEATRI
KOMBËTAR”, NË ZONËN
KADASTRALE 8150, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “d”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë, me sipërfaqe totale 5 522.7 (pesë mijë e pesëqind e njëzet e dy pikë shtatë) m², me adresë: rruga “S. Toptani”, Tiranë, me qëllim ndërtimin e një godine bashkëkohore dhe me standarde të

Teatrit Kombëtar, në konsultim me të gjitha grupet e interesit, sipas hartës kadastrale që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, miratuar me vendimin nr.219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të Qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 30, Fq. 40

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 8150 NR. i PASURISE: 1/241

--> Vije nga: Vol, Fq.

Indeksi i Hartes: TR-P-12

Vije n: Vol, Fq. deri n: Vol, Fq. -->

Adresa e Pasurise: Rrethi TIRANE Q/F TIRANE

PERFUNDIMTARE (data):

Rr/L S.TOPTANI P/G SH K Ap

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurise: TRUALL Brenda V.K.N.: PO, Ref. PL

RREGULL

Sip. Totale e Pasurise:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Nderest
1. 5,522.70 m ²	1. 5,522.70 m ²	1. 1,126.00 m ²
Ref. LN.2004	Ref. LN.2004	Ref. LN.2004
2. m ²	2. m ²	2. m ²
Ref.	Ref.	Ref.
3. m ²	3. m ²	3. m ²
Ref.	Ref.	Ref.
4. m ²	4. m ²	4. m ²
Ref.	Ref.	Ref.

Per pjesen e perbashket:

PALLAT

Kuota e pjesmaries %

Nr i Pasurise (pallat):

Vol Faqe:

Pershkrim i vecante:

TEATRI POPULLOR

PERFUNDIMTARE E REGJISTRIMIT

Z.V.R.P.P

TIRANE

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lesh. Certifikates	Shenime	Firma
LN.2004	25/05/2004	SHTET				I	TIRANE				

Shenim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - perfaqesues i familjes; B - bashkepronar (%)



**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME **TIRANË**
 Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 15 / 3 / 2018

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone
 Në regjistrin Vol 30, Faqe 40, Zona Kadastrale 8150, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI
 VALDRIN PIETRI






HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË REGJISTRUES VALDRIN PIETRI Vula ZVRPP TIRANË	A. IDENTIFIKIMI I PASURISË
	ZONA KADASTRALE <u>BISO</u> NR.PASURISË <u>1/241</u> , VOL. <u>30</u> , FQ. <u>40</u>
	INDEKSI I HARTËS <u>TR-P-11:12</u> , SHKALLA <u>1:1000</u>
	ADRESA E PASURISË: Rrethi: TIRANË, Q/P <u>TIRANË</u>
	Rr/P <u>"S. TOPTANI"</u> , P/G _____, Sh _____, K _____, Ap _____
B. KUFIZIMET	C. PRONARI
V. <u>1/63; 1/143</u>	
L. <u>1/66; 1/137; 1/67</u>	<u>"SHTET"</u>
J. <u>1/11; 1/240; 1/239; 1/62</u>	
P. <u>1/61</u>	
D. Data: ____ / ____ / 2018, Ora _____, Punoj _____	





URDHËR

Nr. 286, datë 30.4.2020

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË
URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020 “PËR
MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E
LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.193, datë 20.3.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pas fjalisë së parë të pikës 3 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Përjashtim nga ky rregull bëhet për pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe farmacitë të cilat ditën e shtunë 2 maj lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në orën 17:30.”

2. Në pikën 3/1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Lejohet aktiviteti i taksive për lëvizje ndërqytetase deri në dy pasagjerë, anëtarë të së njëjtës familje, sipas protokolleve të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

URDHËR

Nr. 287, datë 30.4.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN
NR. 263, DATË 17.4.2020 “PËR
PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË
LËVIZJES PËR KËMBËSORËT
PENSIONISTË, TË SËMURËVE
KRONIKË NË TRAJTIM MJEKËSOR
DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN
E MJETEVE PRIVATE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7 të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 263, datë 17.4.2020 “Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët, pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen e mjeteve private”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si vijon:

“1. Lejohet lëvizja e këmbësorëve pensionistë, ditën e shtunë dhe ditën e diel, datë 2 dhe 3 maj 2020 deri në orën 10:00, të shoqëruar me jo më shumë se një person në krah.”

2. Pika 1/1 riformulohet si vijon:

“1/1. Lejohet lëvizja e prindërve me fëmijëve deri në moshën 14 vjeç, ditën e shtunë dhe ditën e diel, datë 2 dhe 3 maj 2020, nga ora 11:00 deri në orën 17:30, të shoqëruar me persona të tjerë në krah”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

**URDHËR****Nr. 288, datë 30.4.2020****PËR DISA SHTESA NË URDHËRIN
NR.279, DATË 25.4.2020 “PËR
LEHTËSIMIN E POSAÇËM TË
LËVIZJES NË “ZONAT E GJELBËRTA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7 të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19, vendimit të Komitetit Teknik nr.2091, datë 30.4.2020.

URDHËROJ:

Në urdhërin nr. 279, datë 25.4.2020 “Për lehtësimin e posaçëm të lëvizjes në “Zonat e Gjelbërta” bëhen këto shtesa:

1. Pas fjalës Divjakë shtohen fjalët “Belsh, Cërrik, Gramsh, Kucovë, Berat, Tropojë, Maliq, Devoll, Kolonjë, Ura Vajguore, Mallakastër, Rrogozhinë, Pustec, Skrapar, Polican, Selenicë, Vlorë”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë